



KOMUNA VUSHTRRI

**KORNIZA AFATMESME BUXHETORE
2016-2018**

KOMUNA E VUSHTRRIË

Përmbajtja

| | |
|---|----|
| Hyrja..... | 2 |
| Prioritet strategjike..... | 2 |
| Ekonomia lokale..... | 3 |
| Swot analiza..... | 4 |
| Vizioni i Komunës..... | 5 |
| Misioni i Komunës..... | 5 |
| Prioritetet e Komunës..... | 6 |
| Korniza fiskale komunale – Të hyrat..... | 7 |
| Burimet e Financimit Komunal për vitin 2016-2018..... | 8 |
| Granti i Përgjithshëm për vitin 2016..... | 10 |
| Granti specifik për Arsim para universitar për vitin 2016..... | 11 |
| Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2016..... | 11 |
| Të hyrat vetanake komunale për vitin 2016 dhe parashikimet 2017-2018..... | 12 |
| Donatorët e jashtëm (ndërkombëtar)..... | 15 |
| Shpenzimet Afatmesme Komunale – Korniza buxhetore..... | 16 |
| Plani i zhvillimit kapital..... | 23 |

Hyrje

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB)2016 - 2018 parqet dokumentin strategjik mbi bazën e të cilit planifikohet buxheti për vitin 2016 dhe projekcioni për dy vitet e ardhshme. Ky dokument ofron një analizë të hollësishme të të hyrave në dispozicion të Komunës dhe në bazë të këtyre të hyrave planifikohen shpenzimet publike. Shpenzimet e planifikuara pasqyrojnë prioritetet strategjike për zhvillimin e vazhdueshëm të komunës. KAB siguron një mekanizëm të dobishëm përmes të cilit prioritetet e identifikuara në dokumentet strategjike të komunës mund të integrohen më mirë në procesin e buxhetit.

Hartimi i KAB-së është një kërkesë obligative dhe kërkohet përmes Qarkores Komunale të Buxhetit 2016/01 të lëshuar nga Ministria e Financave me datë 15.05.2015.

Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB)2016 – 2018 është bazuar në Strategjinë e zhvillimit ekonomik të Komunës së Vushtrrisë 2013-2018 e cila ofron një kornizë për programin e zhvillimit ekonomik për të drejtuar komunitetin e qytetarëve në Vushtrri në drejtimin e objektivave strategjike.

KAB paraqet një planifikim afatmesëm. Karakteristikat më kryesore të tij janë si në vijim:

- Perspektivë afatmesme e planifikimit buxhetor – 3 vjeçar
- Ndërlidhja e prioritetëve të politikave me ndarjen e mjeteve, d.m.th. me buxhetin
- Theksimi i shfrytëzimit efikas të burimeve të kufizuara publike (si atyre kapitale ashtu edhe atyre operative)

Prandaj procesin që kemi ndjekur ne është si në vijim:

- Rishikimi i politikave të të hyrave dhe identifikimi i të hyrave në dispozicion
- Paraqitja e prioritetëve strategjike dhe rezultateve të pritura
- Rishikimi i ndërlidhjes së buxhetit të kaluar me prioritetet dhe rezultate
- Planifikimi i buxhetit për periudhë afatmesme për të punuar drejt arritjes së prioritetëve strategjike
- Zhvillimi i indikatorëve dhe caqeve për të matur progresin drejt prioritetëve strategjike dhe rezultateve

Kjo KAB paraqet prioritetet komunale të shpërndarjes së mjeteve për periudhën 2016-2018.

KAB-ja do të përditësohet pas miratimit të buxhetit vjetor komunal (2016) nga Kuvendi i Komunës dhe të rishikohet pas 12 muajsh si pjesë e procesit përgatitor të buxhetit vjetor.

Prioritetet strategjike të Komunës

Vushtrria si komunë ka pozitë të përshtatshme gjeografike dhe ekonomike. Territori i Komunës së Vushtrrisë gjendet në pjesën veriore të Kosovës. Komuna shtrihet në drejtim veri-jug (gjatësia maksimale afro 34 km) dhe diç më e zgjeruar në mes (gjerësia maksimale afro 23 km) me një gjatësi të vijës kufitare prej afro 104.5 km. Territori i komunës gjendet në mes të këtyre koordinatave gjeografike:

X1 : 200 50' 09" dhe X2 : 210 07' 05";
Y1 : 420 42' 20" dhe Y2 : 420 55' 12".

Territori i Komunës së Vushtrrisë zë afro 3.2% të sipërfaqes të tërë territorit të Republikës së Kosovës. Komuna e Vushtrrisë në veri kufizohet Mitrovicën, në lindje me Podujevën, në jug me Obiliqin, në jugperëndim me Drenasin dhe në perëndim me Skenderajn. Në përgjithësi relievi i Komunës së Vushtrrisë është i butë dhe kodrinor. Nëpër territorin e Komunës së Vushtrrisë rrjedh lumi Silnica, me disa degë të tij dhe një pjesë e rrjedhjes së poshtme të lumit Llap. Pas Drinit të Bardhë, Silnica është lumi me sipërfaqen më të madhe ujëmbledhëse prej 2912 km².

Ekonomia lokale

Në komunën e Vushtrrisë operojnë rreth 2,412 biznese. Numri më i madhe i këtyre bizneseve janë të orientuar në veprimtari tregtare. Duke u bazuar në të dhënat Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, rreth 37.48 % e bizneseve merren me tregti, 16.79% me transport dhe telekomunikacion, 10.12 % hynë shërbimet hoteliere, restorantet, përgatitja e ushqimit etj. Agrobiznesi është me i zhvilluari dhe akoma një sektor premtues për zhvillimin e ardhshëm të Vushtrrisë, kryesisht Komuna jone prin në prodhimin e patates, përpunimi i patates nga “Vipa Chips” zen vend të rëndësishëm në ekonominë e Komunës. Gjithashtu edhe industria e përpunimit të drurit është mjaft e zhvilluar si fabrikat ” Bini”, “Berto” etj. Duhet të ceket se nga ky numër i bizneseve vetëm 1,604 janë aktive.

| | Veprimtarit ekonomike | Numri i bizneseve | Përqindja |
|----|---|-------------------|------------|
| 1 | Bujqësia, Gjuetia dhe pylltaria | 148 | 6.14 |
| 2 | Peshkimi | 2 | 0.08 |
| 3 | Industria nxjerrëse | 15 | 0.62 |
| 4 | Industria përpunuese | 203 | 8.42 |
| 5 | Prodhimi me energji elektrike, gaz, ujë, avull, ujë të ngrohtë | 4 | 0.17 |
| 6 | Ndërtimtaria | 154 | 6.38 |
| 7 | Treg.me shumice dhe pakice, rip. i auto dhe aparateve tjera të amvisëri | 904 | 37.48 |
| 8 | Hotelet dhe Restorantet | 244 | 10.12 |
| 9 | Transporti, depot dhe telekomunikacion | 405 | 16.79 |
| 10 | Aktivitetet financiare | 3 | 0.12 |
| 11 | Afarizmi me pasurit e patundshme | 95 | 3.94 |
| 12 | Administrimi dhe mbrojtja publike, mbrojtja e obligueshme sociale | 3 | 0.12 |
| 13 | Arsimi | 27 | 1.12 |
| 14 | Shëndetësia | 47 | 1.95 |
| 15 | Aktivitet tjera shoqërore dhe personale | 158 | 6.55 |
| | Totali | 2,412 | 100 |

SWOT ANALIZA

Vushtrria, si shumica e komunave në Kosovë, ballafaqohet me sfida të ndryshme zhvillimore, por njëkohësisht, për shkak të pozicionit gjeografik dhe potencialeve që ka, është edhe rast i mundë- sive për zhvillim të qëndrueshëm në sferën ekonomike, administrative dhe sociale. Në këtë drejtim analiza e përparësive, mundësive, dobësive dhe rreziqeve paraqet një faktor të rëndësishëm për të determinuar objektivat strategjike të komunës në pesë vitet e ardhshme.

| | |
|--|--|
| <p>Përparësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pozita e volitshme gjeografike • Distanca rrugore e Vushtrrisë nga kryeqendra e Kosovës-Prishtina 25 km, nga Mitrovica 10 km • Resurset natyrore • Toka pjellore për bujqësi Rrjedha e lumit Silnica • Sipërfaqe të mjaftueshme të tokës • Tradita bujqësore dhe agro-industriale • Prodhimi cilësor i farës së patates • Niveli i zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM-ve) • Zhvillimi i industrisë agrikuturore • Burimet natyrore të pranishme në disa lokacione në këtë zonë • Infrastruktura relativisht e mirë • Popullsia me prirje për zhvillim të ekonomisë së vogël • Sistemi i ujitjes • Ambient i mirë për blegtori αTransporti hekurudhor | <p>Dobësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mosshfrytëzimi i tokës bujqësore në masë të duhur • Ndotja mjedisore prezente • Menaxhimi joadekuat mjedisor • Shërbimet shëndetësore jo të mjaftueshme- implementimi jo i plotë i konceptit të mjekësisë familjare • Furnizimi jostabil me energji • Të dhënat e kufizuara në të gjithë sektorët ekonomikë αMungesa e mbështetjes së mjaftueshme për sektorin privat • Qasja e kufizuar në kapital. • Sistemi arsimor jompatibil me kërkesat e tregut të punës. • Infrastruktura jo e mjaftueshme për aktivitete kulturore, rini dhe sport |
| <p>Mundësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bujqësia – zhvillimi i produkteve lokale • Përmirësimi i infrastrukturës së biznesit– p.sh. inkubatorët, parqet e biznesit dhe zonat industriale • Kthimi i fondeve financiare nga jashtë, lirimi i fondeve të bllokuara brenda shtetit. Përfshirja e diasporës në identifikimin e tregjeve globale për produktet e • Vushtrrisë-Kosovës dhe promovimin e tyre • Mjedisi – adaptimi i planeve urbane, rehabilitimi i zonave të degraduara, ripyllëzimi, riciklimii i mbeturinave, krijimi i një plani për trajtimin e ujit të ndotur • Burimet alternative të energjisë αIndustria agrikuturore dhe prodhuese | <p>Rreziqet</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mungesa e zbatimit strikt të infrastrukturës ligjore për funksionimin efikas të ekonomisë së tregut • Konkurrenca jolojale në treg (rajonale) • Politika jo e drejtë ekonomike ndaj agrobiznesit (prodhimtaria e farës së grurit, sojës, patates, lulediellit, bimëve industriale) • Kriza rajonale si rrjedhim i krizës globale që ndikon në aftësinë për të tërhequr investitorë/donorë. • Mosaplikimi i Marrëveshjeve për Tregti të Lirë me shtetet fqinje posaçërisht me Serbinë dhe Bosnjën (barrierat e ndryshme tarifore dhe jotarifore për lëvizjen e mallrave dhe kapitalit) • Përrjashtimi i Kosovës nga procesi i liberalizimit |

| | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • Investimet e jashtme dhe lokale (FDI) • Infrastruktura – ndërtimi i autostradës • Turizmi – zhvillimi i turizmit rural • Burimet njerëzore: Ngritja e kapacitetit profesional njerëzor | <p>të vizave kufizon lëvizjen e lirë të njerëzve dhe mallrave.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndarja në baza etnike e trashëgimisë kulturore |
|---|---|

VIZIONI I KOMUNËS

Rajoni i Vushtrrisë ka potencial rinor i cili kërkon arsim cilësor, mbështetje të punësimit përmes rritjes së investimeve dhe mbështetjes së sektorit privat, krijim të klimës së favorshme për të zhvilluar biznes, e cila në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ndikojë në rritjen e punësimit dhe në përmirësimin e kushteve të jetesës për të gjithë qytetarët. Përmes zhvillimit dhe bashkëpunimit ekonomik rajonal, për të krijuar mundësi të barabarta dhe mirëqenie për të gjithë qytetarët e saj, të matur me infrastrukturë cilësore, mjedis të pastër dhe zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, të cilat janë në pajtim me standardet e BE-së. Në pesë vitet e ardhshme vizioni i Vushtrrisë është që të jetë komunë me rritje të lartë ekonomike dhe nivel të ulët të papunësisë në Kosovë, me administratë moderne komunale dhe arsim të nivelit evropian.

MISIONI I KOMUNËS

Komuna e Vushtrrisë do të zhvillojë dhe do të ngrisë mirëqenien ekonomike, sociale, kulturore dhe fizike, do të sigurojë një jetë me të mirë për të gjithë qytetarët e saj nëpërmjet këtyre shtyllave:

- Zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik
- Avancimit të arsimit dhe edukimit
- Përmirësimit të shëndetësisë dhe mirëqenies sociale
- Zhvillimit të infrastrukturës dhe ruajtjes së ambientit
- Promovimit të turizmit, kulturës dhe sportit
- Rritjes së efikasitetit të administratës publike

PRIORITETET E KOMUNËS

Prioriteti 1

Mbështetja e zhvillimit ekonomik të planifikuar me sisteme infrastrukturash publike të ndërtuara në nivele që adresojnë nevojat dhe i paraprijnë zhvillimit të veprimtarive private e publike cilësore.

Prioriteti 2

Shndërrimi i Vushtrrisë në një zonë ku bizneset ruhen, rriten e zhvillohen në sektorët e prodhimit, përpunimit e tregtimit të produkteve, kryesisht tradicionale dhe ku mundësitë dhe burimet shfrytëzohen në mënyrë racionale për të nxitur shërbime cilësore dhe turizëm.

Prioriteti 3

Arritja e standardeve bashkëkohore të shërbimeve publike në një klimë bashkëpunimi të ngushtë mes komunitetit dhe qeverisë së mirë komunale, ku krijohet lehtësi për të bërë biznes dhe për të investuar.

Prioriteti 4

Promovimi i shumëllojshmërisë së ekonomisë në Vushtri.

Prioriteti 5

Sektori i prodhimtarisë duhet të forcohet, i fokusuar në industrinë ndërtimore, në përpunim të drurit dhe në agrobiznes.

Prioriteti 6

Mbështetje në krijimin e bizneseve të reja përmes “inkubatorëve” lehtësues.

Prioriteti 7

Krijimi i zonave të përshtatshme ekonomike me të gjithë infrastrukturën e nevojshme.

Nga këto prioritete të caktuara me Strategjinë e Zhvillimit ekonomik 2013 - 2018

- Komuna gjate vitit 2014 ka përgatitur infrastrukturë për bizneset te cilat operojnë ne komunën tone, gjë me te cilin ka ndikuar edhe ne zhvillimin ekonomik edhe me te shpejt te zgjerimit te bizneseve duke rritur edhe numrin e te punësuarave.
- Gjate vitit 2014 bizneset e komunës sonë te cilat kane krijuar standarde për prodhim dhe përpunim janë zgjeruar edhe me tej duke ngritur kapacitetin e prodhimit dhe përpunimit te tyre, siç janë Pestova Shpk, Berto Shpk. Binni Shpk Ndryshimi i Rregullores mbi ngarkesat, tarifatat dhe gjobat komunale kane ndikuar qe shumica e bizneseve te cilat merren me artizanat te vjetra janë liruar nga taksat, edhe bizneset e vogla po ashtu janë liruar.
- Gjatë vitit paraprak Drejtoria për Ekonomi ka zhvilluar një bashkëpunim shume te mire me komunitetin e biznesit. Gjate kësaj periudhe Drejtoria për Ekonomi ka afruar një shërbim duke i vizituar pothuaj çdo biznes dhe duke u merr me hallet dhe problemet e tyre për te krijuar një klimë sa me te mire për biznese. Gjate vitit 2014 MTI se bashku me Oden Ekonomike te Kosovës ka zgjedhur bizneset me te suksesshme për regjionin r Mitrovicës, dy Kompanitë e Vushtrrisë janë zgjedhur si me te suksesshem:
 - Kompania Pestova ka marre vendin e parë
 - Kompania Berto ka marr vendin e tretë

Po ashtu gjate vitit 2014 ne raportin e Kosovës për Indeksin e Konkurrencës në Komuna,

te kryer nga Agjencinë UBO Consulting së bashku me përfaqësues te USAID – it, ku komuna jonë është shpërblye me dy qmime:

- Gjate vitit paraprak vërehet një shumëllojshmëri të veprimtarive te bizneseve te cilat janë te regjistruara, posaçërisht vërehet veprimtaria shërbyese.

Përveç kësaj edhe veprimtarit prodhuese, përpunuese kane ofruar apo janë zgjeruar me veprimtari heterogjene te veprimtarisë të prodhimeve te tyre.

Buxheti për periudhën afatmesme 2016-2018 është planifikuar në pajtim me këto fusha prioritare të Komunës.

Korniza fiskale komunale – Të hyrat

Edhe pse komuna nuk e udhëheq drejtpërdrejtë politikën makroekonomike pasi që kjo është në përgjegjësi të qeverisë qendrore mjedisi i përgjithshëm ekonomik kombëtar ka një ndikim në pasqyrën fiskale komunale.

Korniza afatmesme komunale është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe dokumenteve të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2016-2018 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Parashikimi i të hyrave për periudhën 2016-2018 është bërë mbi bazën e skenarit makroekonomik të bazuar në pritjet për rimëkëmbjen dhe rritjen e aktivitetit ekonomik. Ky parashikim gjithashtu merr për bazë edhe supozimin për përmirësimin e vazhdueshëm të efikasitetit të agjencive përgjegjëse për grumbullimin e të hyrave, implementimin e politikave të reja tatimore dhe implementimin e projekteve kapitale Si rrjedhojë e zhvillimeve të lartpërmendura, të hyrat e përgjithshme përgjatë periudhës 2016-2018 parashihet të rriten me një normë mesatare vjetore prej rreth 1%. Rritja ekonomike për vitin 2014 u vlerësua të jetë 3.3%, ndërsa duke konsideruar zhvillimet ekonomike globale e në veçanti ato të eurozonës, rritja për vitin 2015 parashikohet të jetë 3.8%, për t'u stabilizuar në 4.4% në mesatare përgjatë periudhës afatmesme 2016-2018

Indikatorët ekonomik komunal

| Përshkrimi | 2015 (buxheti) | 2016 | 2017 | 2018 |
|--|----------------|--------|--------|--------|
| Indikatorët makroekonomik në Kosovë | | | | |
| *Rritja reale e BPV në % | 3.8 | 4.1 | 4.5 | 4.4 |
| *Inflacioni në % | 1.0 | 0.7 | 0.9 | 0.9 |
| *BPV për kokë banori, në euro | 3.050 | 3.148 | 3.261 | 3.402 |
| Indikatorët ekonomik komunal | | | | |
| Popullsia e Komunës | 72.000 | 73.296 | 74.615 | 75.958 |
| Nr. i bizneseve të regjistruara | 2.412 | 2627 | 2844 | 3074 |
| Nr. i nxënësve | 15,657 | 15.620 | 15.600 | 15.550 |

*Burimi: Korniza Afatmesme e Shpenzimeve, Qeveria e Kosovës, 2016-2018

Burimet e Financimit Komunal për vitin 2016-2018

Financimi komunal përfshinë: grantin e përgjithshëm, grandet specifike operative për arsim para universitar dhe shëndetësi primare, grandet për kompetencat e shtuara, të hyrat vetanake të komunave, transferet për kompetencat e deleguara, grandet e jashtëzakonshme, ndihma financiare nga jashtë. Ndërsa, aspekti i huamarrjes së komunave do të jetë si opsion i mundshëm i financimit që është paraparë në ligjin përkatës dhe në kuadër të rregullës fiskale të përcaktuar në draft

LMFPP të akorduar me Misionin e FMN-së. Të gjitha të hyrat nga burimet në vijim janë të hyra vetanake të komunës: tatimi në pronë, taksat komunale, gjobat, tarifatat dhe pagesat në pajtim me autoritetin që u është dhënë komunave me LFPL.

Komunat pranojnë Grande Operative nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe ato janë:


Grandi i përgjithshëm

Grandi specifik për Arsim

Grandi specifik për Shëndetësi

Financimi nga të hyrat 2016-2018

| Komuna: Vushtrri | Grante dhe të hyra vetanake (HV) – 2015 | Grante dhe të hyra vetanake – 2016 | Grante dhe të hyra vetanake – 2017 | Grante dhe të hyra vetanake - 2018 |
|-----------------------------------|---|------------------------------------|------------------------------------|------------------------------------|
| | në Euro | në Euro | në Euro | në Euro |
| Burimet e të hyrave | | | | |
| Granti i përgjithshëm | 5.701.925.00 | 4.940.531.00 | 5.036.252.00 | 5.150.153.00 |
| Granti për arsim | 5.596.231.00 | 6.291.206.00 | 6.291.206.00 | 6.291.206.00 |
| Granti për shëndetësi | 1.651.936.00 | 1.651.936.00 | 1.651.936.00 | 1.651.936.00 |
| Gjithsej Grantet | 12.950.092.00 | 12.883.673.00 | 12.979.394 | 13.093.295 |
| Të bartura | 417.271.50 | xxxxxxx | xxxxxxx | xxxxxxx |
| Viti aktual | 1.675.327.00 | 1.703.418.00 | 1.703.418.00 | 1.730.000.00 |
| Gjithsej të hyrat vetanake | 2.092.598.50 | 1.703.418.00 | 1.703.418.00 | 1.730.000.00 |
| GJITHSEJ TË HYRAT KOMUNALE | 15.042.690 | 14.587.091.00 | 14.682.812 | 14.823.295 |



Granti i Përgjithshëm për vitin 2016

Tabela: Struktura e Grantit të Përgjithshëm për periudhën 2016-2018 (mil. Euro)

| Kriteret | Faktorët | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 |
|------------------------------------|---|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| | | Aktual | Buxheti | Vlerësimi | Vlerësimi | Vlerësimi |
| Shuma agregate | Të hyrat buxhetore (mil euro) | 1,278.0 | 1,457.6 | 1,349.1 | 1,374.9 | 1,405.6 |
| | 10% e të hyrave buxhetore (mil euro) | 127.80 | 145.76 | 134.91 | 137.49 | 140.56 |
| Kosto shtesë nga Niveli Qendror | Ndikimi nga regjistrimi i popullsisë 2011, sipas nenit 35 të LFPL | 9.77 | | | | |
| Elementet | Shuma Fikëse | 3.63 | 3.63 | 3.63 | 3.63 | 3.63 |
| | Popullsia | 1,780,021 | 1,780,021 | 1,780,021 | 1,780,021 | 1,780,021 |
| | Parametri: 89% e shumës agregate | 110.5 | 118.06 | 116.83 | 119.13 | 121.86 |
| | Zona komunale (km2) | 10,901 | 10,901 | 10,901 | 10,901 | 10,901 |
| | Parametri: 6% e shumës agregate | 7.45 | 7.9 | 7.87 | 8.03 | 8.21 |
| | Komunitetet pakicë në komunë | 107,926 | 107,926 | 107,926 | 107,926 | 107,926 |
| | Parametri: 3% e shumës agregate | 3.7 | 3.9 | 3.93 | 4.01 | 4.1 |
| | Popullsia e komunave pakicë | 62,031 | 62,031 | 62,031 | 62,031 | 62,031 |
| | Parametri: 2% e shumës agregate | 2.4 | 2.6 | 2.62 | 2.67 | 2.74 |
| Total granti i përgjithshëm | | 137.57 | 145.76 | 134.91 | 137.49 | 140.56 |

Komunat do të pranojnë grantin e përgjithshëm, i përcaktuar si grant me sistem të mbyllur dhe do ta shfrytëzojnë për ushtrimin e kompetencave të caktuara komunale në përputhje me kuadrin ligjor. Granti i përgjithshëm mundëson një shkallë të arsyeshme të qëndrueshmërisë buxhetore komunale, është mekanizëm për sigurimin e barazisë ndërmjet komunave si dhe mundëson alokimin adekuat të burimeve për komunitet pakicë në komunat përkatëse.

Bazuar në LFPL, shuma e grantit të përgjithshëm është e përcaktuar me dhjetë për qind (10%) e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore, duke përjashtuar të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat e jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara vetanake të nivelit qendror dhe të hyrat nga huamarrja.

Granti i përgjithshëm për vitin 2016 është aprovuar në shumë prej 134,910,000 euro, bazuar në të hyrat reale nga tabela makro-fiskale 2016-2018 dhe duke aplikuar parimet, kriteret dhe formulat e përcaktuara në LFPL

Në bazë të kriterëve të formulës për alokimin e grantit Komunës së Vushtrrisë i takon:

| | |
|---|-----------|
| Shuma për popullsi (89%) | 4.585.981 |
| Shuma për madhësi gjeografike (6%)..... | 249.390 |
| Shuma për popullsi pakicë (3%)..... | 35.030 |
| Shuma fikse 140.000-1€..... | 70.130 |
| TOTAL..... | 4.940.531 |

Sikur në të gjitha komunat tjera të Kosovës e Vushtrrisë vazhdon që në masë të madhe të financohet nga transferet qeveritare të cilat në tre vitet e ardhshme do të përbëjnë afërsisht 88% të buxhetit të përgjithshëm të komunës.

Granti specifik për Arsim para universitar për vitin 2016

Arsimi është një ndër shtyllat afatgjate të zhvillimit ekonomik , në këtë periudhë do të punohet në zhvillimin e një vizioni të ri të arsimit, në të njëjtën kohë do të investohet në krijimin e hapësirave të përshtatshme për zhvillimin normal të procesi mësimor.

Granti Specifik për Arsim sipas LFPL bazohet në qasjen me sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh statistikën bazë dhe duke aplikuar kriteret dhe parametrat në formulë për ndarjen e grantit specifik për arsim para universitar për vitin 2016 është aprovuar në shumën prej 161,332,014 euro. Në kuadër të grantit specifik për arsim është kalkuluar kostoja për sigurimin shëndetësor si dhe kostoja për përvojën e punës prej 0.5% për vit pune.

Bazuar në këto kritere dhe parametra Komunës së Vushtrrisë i ndahen 6.291.206 Euro , këto mjete janë të pamjaftueshme , mirëpo duke marrë parasysh se Granti Specifik për Arsim bazohet në sistemin e hapur Komuna nga Granti i përgjithshëm duhet ta financoj arsimin

Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2016

Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore është domosdoshmëri ,prandaj reformimi i këtij sistemi do të ketë qëllim rritjen e performancës shëndetësore dhe krijimi i një sistemi të qëndrueshëm financiar. Në kuadër të dokumenteve strategjike për vitin 2016 është llogaritur kostoja e Sigurimeve shëndetësore

Granti specifik për Shëndetësi dhe përcaktimi i shumës së këtij granti bazohet në një qasje me sistem të hapur të financimit në përputhje me LFPL. Granti specifik për shëndetësi primare për vitin 2016 është aprovuar në shumë prej 42,085,037 euro. Shpërndarja e grantit specifik bazohet në formulën që merr parasysh numrin e vizitave për kokë

banori shumëzuar me koston mesatare për vizitë, dhe numrit të shërbimeve shumëzuar me koston mesatare për shërbime.

Kriteret e aplikuara për ndarjen e grantit specifik për shëndetësi për vitin 2016 janë, si vijon:


- 2.5 vizita për kokë banori me një kosto prej 4€ për një vizitë, dhe

- 3.5 shërbime për kokë banori me një kosto prej 3.89 € për një shërbim.

Prandaj në bazë të këtyre kriterëve për Komunën e Vushtrrisë janë ndarë 1.651.936.00 Euro , kjo shumë është e barabartë me shumën e ndarë për vitin 2015

Të hyrat vetanake komunale për vitin 2016 dhe parashikimet 2017-2018

Trendi i realizimit të të Hyrave vet anakë nga viti 2012 ka shënuar rritje rreth 10% , por ende nuk është në nivelin e planifikimit , Gjatë vitit 2015 pritet të hyjë në fuqi Ligjit për Faljen e Borgjeve i cili me siguri do të ketë ndikim në realizimin e Tatimit në pronë dhe në përgjithësi për të hyrat vetanake, ky ligj do ta ketë ndikimin edhe në vitin 2016. Për vitet në vijim pritet hyrja në fuqi të Ligjit për Tatimin e Pronave Bujqësorë si dhe Ligji mbi Legalizimin e Objekteve ndërtimore . Hyrja në fuqi e këtyre ligjeve do të ndikojë në ngritjen e të Hyrave vetanake dhe me këtë do të shkohet në parimin e financimit të Komunave nga të Hyrat vetanake i cili edhe kërkohet nga FMN



Planifikimi i të hyrave vetanake të komunës sipas burimeve për periudhën 2016-2018, në euro

| | Komuna: Vushtrri | THV - 2016 | THV - 2017 | THV - 2018 |
|-------------|---|---------------------|---------------------|---------------------|
| 644.00 | | në Euro | në Euro | në Euro |
| I-A. | TË ARDHURAT E ADMINISTRATËS KOMUNALE - Direkte | | | |
| 1 | Buxhet dhe Financa | 637,118.00 | 637,118.00 | 675,500.00 |
| 1.1. | Taksat e firmave | 95,000.00 | 95,000.00 | 95,000.00 |
| 1.2. | Tatimi në Pronë | 512,118.00 | 512,118.00 | 550,000.00 |
| 1.3. | Transakcionet | 30,000.00 | 30,000.00 | 30,500.00 |
| 2 | Inspeksioni | 12,800.00 | 12,800.00 | 11,827.00 |
| 2.1 | Pranime teknike | 5,000.00 | 5,000.00 | 5,827.00 |
| 2.2 | Pelqime sanitare | 7,300.00 | 7,300.00 | 5,000.00 |
| 2.3 | Gjobat e inspektionit | 500.00 | 500.00 | 1,000.00 |
| 3 | Administrata | 87,000.00 | 87,000.00 | 87,500.00 |
| 3.1. | Sherbimet Administrative | 87,000.00 | 87,000.00 | 87,500.00 |
| 4 | Urbanizmi | 410,000.00 | 410,000.00 | 406,673.00 |
| 4.1. | Lejet për ndërtim dhe konstruktive | 330,000.00 | 330,000.00 | 298,000.00 |
| 4.2 | Shfrytëzimi I pronës Publike | 80,000.00 | 80,000.00 | 108,673.00 |
| 5 | Gjeodezi dhe Kataster | 80,000.00 | 80,000.00 | 80,000.00 |
| 5.1. | Hipoteka,RDDP,Dalje teren | 56,000.00 | 56,000.00 | 56,000.00 |
| 5.2. | Listat poseduse,kopje plani,vertetime tjera. | 24,000.00 | 24,000.00 | 24,000.00 |
| 6 | Ekonomi dhe Bujqsia | 15,000.00 | 15,000.00 | 15,000.00 |
| 6.1 | Ndrimi I tokes bujqesore në ndertimore | 15,000.00 | 15,000.00 | 15,000.00 |
| 7 | Kultur Rini Sport | 7,100.00 | 7,100.00 | 7,500.00 |
| 7.1. | Palestra sportive | 5,000.00 | 5,000.00 | 5,000.00 |
| 7.2. | Biblotekat | 2,000.00 | 2,000.00 | 2,000.00 |
| 7.3. | Shtepia e Kultures | 100.00 | 100.00 | 500.00 |
| 9 | Sherbimet Publike | 101,400.00 | 101,400.00 | 115,000.00 |
| 9.1. | Ndalja e veturave në rrugë | 4,400.00 | 4,400.00 | 8,000.00 |
| 9.2 | Taksat Rrugore | 97,000.00 | 97,000.00 | 107,000.00 |
| I-A. | Nëntotali I-A , Të ardhurat direkte (Tarifat dhe ngarkesat) | 1,350,418.00 | 1,350,418.00 | 1,399,000.00 |
| 1.0. | Denimet në komunikacion,të grumbulluara përmes Nivelit Qendror (ShPK) | 53,000.00 | 53,000.00 | 53,000.00 |
| 1.1. | Denimet e gjykatave | 160,000.00 | 160,000.00 | 155,000.00 |
| I - B. | Nëntotali I-B , Të ardhurat indirekte (Pjesa që i takon komunave) | 213,000.00 | 213,000.00 | 208,000.00 |
| I | Totali I Administrates komunale (Direkte dhe Indirekte & IA+IB) | 1,563,418.00 | 1,563,418.00 | 1,607,000.00 |
| | TË ARDHURAT NGA ARSIMI | 85,000.00 | 85,000.00 | 73,000.00 |

Vërejtje: KAB 2016-18 bëhet përfundimtare pas miratimit të buxhetit vjetor 2016 nga Kuvendi Komunal

| | | | | |
|------------|--|---------------------|---------------------|---------------------|
| 1 | Qerdhet | 50,000.00 | 50,000.00 | 40,000.00 |
| 2 | Arsimi parashkollor | | | |
| 3 | Arsimi fillor | | | |
| 4 | Mësimi joformalSHMP "Bahri Haxha" | 17,000.00 | 17,000.00 | 17,500.00 |
| 5 | Mësimi joformalSHMT "Lutfi Musiqi" | 18,000.00 | 18,000.00 | 15,500.00 |
| 6 | Të tjera | | | |
| II | Totali - Arsimi | - | | - |
| | Të ARDHURAT NGA SHËNDETËSIA | 55,000.00 | 55,000.00 | 50,000.00 |
| 1 | Shëndetësia primare | 55,000.00 | 55,000.00 | 50,000.00 |
| 2 | Të tjera | | | |
| Kodi 21 | TOTALI I TË ARDHURAVE VETANAKE TË KOMUNES (I+II+III): | 1,703,418.00 | 1,703,418.00 | 1,730,000.00 |
| IV. | Donatorët e mbrenshem (IV) | | | |
| 1.1 | Participimi I popullates | 25,000.00 | 25,000.00 | 25,000.00 |
| 1.2 | Grantet e donatorve te mbrendshëm (ministritë apo të tjerë) | | | |
| 1.3 | Të hyrat dhe donacionet tjera | | | |
| 1.4 | Tjera | | | |
| Kodi 31 | Total (IV) | 25,000.00 | 25,000.00 | 25,000.00 |
| V | Donatorët e Jashtëm (V) | | | |
| | Gjithsej të ardhurat e komunës (I+II+III+IV) | 1,728,418.00 | 1,728,418.00 | 1,755,000.00 |

Donatorët e jashtëm (ndërkombëtar)

Vlera e përgjithshme e financimeve nga donatorë të jashtëm për zbatimin e projekteve të ndryshme për komunë, në vitin 2015 ka qenë 983.152.25 (Tabela 4) e cila përndryshe përbën 2.4% të buxhetit të përgjithshëm të komunës në vitin 2015. Nga këto shuma disa janë direkte .

Tabela 4: Të hyrat nga donatorë të jashtëm për vitet 2015-2017

| Përshkrimi i projektit | Donatori | Viti 2015 (Aktual) | Viti 2016 | Viti 2017 (Planifikuar) |
|---|--------------------|--------------------|------------------|----------------------------|
| Promovimi i punësimit të rinisë | Qeveria Daneze | 5.752.71 | | |
| Platforma mbledhja ,paketimi i mbet. | Unioni Evropian | 337.735.54 | | |
| furniz.mjete per puntor.saldator-axhustatoreve | Qeveria Franceze | 10.000.00 | | |
| pasur.bibl.muz.liter.mbi trashëgimin | Qeveria Suedeze | 5.000.00 | | |
| Promovim.i te drejt. Njeriut | Këshilli i Evropës | 14.400.00 | | |
| Sistemi i furnizimit me ujë | Lux Development | 305.000.00 | 155.000.00 | |
| Objekti i Komunës | Bashkimi Evropian | | 1.274.000.00 | |
| Projekte te ndryshme | USAID | 45.264,00 | 80.000,00 | 53.000,00 |
| Shtirirja e rrjetit te ujesjellësit për fshatrat rreze Qiqavices | CDI- Zvicereane | 260.000,00 | 300.000,00 | 300.000,00 |
| Gjithsej | | 983.152.25 | 1.809.000 | 353.000 |


Politika e komunës është të kërkojë ndihmën e donatorëve të jashtëm në fushat prioritare janë kryesisht në përmirësimin e infrastrukturës.

Shpenzimet Afatmesme Komunale – Korniza buxhetore

Trendi i shpenzimeve komunale dhe parashikimet afatmesme për periudhën 2016-2018

Në bazë të udhëzimeve të dhëna në Qarkoren Buxhetore 2016/01 komuna i paraqet parashikimet në vijim të shpenzimeve brenda kufijve të caktuar nga Ministria e

Financave:



Diskutime për kategoritë kryesore të shpenzimeve dhe çështjet që kanë ndikim në dallime të mëdha.....

Pagat dhe Mëditjet – Siç u pa në grafikun më lart kjo kategori përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve , rreth 60 % e shpenzimeve totale .Kjo kategori ka shënuar rritje për 4% si rrjedhojë e kostos për rritjen pagesës për

përvojën e punës dhe sigurimet shëndetësorë për të gjitha kategoritë që marrin paga nga Buxheti i Kosovës. Për vitet në vijim kjo kategori pritet të ketë rritje por jo me të madhe se 0.4 % Pjesëmarrja e kategorisë së pagave dhe mëditjeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore komunale pritet të mbetet përafërsisht 60%.

Mallrat dhe shërbimet – Kategoria e shpenzimeve për mallra dhe shërbime ka pasur rritje nominale nga viti 2014 në 2015 e tutje – Për vitet në vijim do të shënohet një rritje e konsiderueshme në këtë kategori që është kryesisht si rezultat i shpenzimeve të shtuara për mirëmbajtjen e projekteve (të reja) kapitale, shkollave, ambulancave, objekteve sportive, etj.) si dhe nevoja e shtuar për material shpenzues. Pjesëmarrja e kësaj kategorie të shpenzimeve në shpenzimet e përgjithshme buxhetore në 3 vitet e ardhshme pritet të jetë mesatarisht prej 10%. Meghi thate , buxheti për këtë kategori do të orientohet në mirëmbajtjen dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve, duke e reduktuar buxhetin për shpenzime jo produktive.

Komunalitë – Kategorisë së shpenzimeve komunale i kushtojmë rëndësi të madhe edhe pse në buxhetin e përgjithshëm merr pjesë rreth 1.5%. Me kursime të arsyeshme të kësaj kategorie edhe në vitet në vijim pjesëmarrja në shpenzimet totale do të jetë e njëjtë

Subvencionet – Duke marrë parasysh nevojat e qytetarëve për Subvencione , Komuna i ndanë disa mjete për nevoja emergjente si : Subvencionimi i klubeve sportive, për shërim të disa rasteve më të ndjeshme, qira , raste sociale ,bursa , subvencione për Bujqësi dhe disa raste të veçanta. Komuna e Vushtrrisë për kategorinë e Subvencioneve viteve të kaluara ka ndarë rreth 220.000. € Kjo shume nuk është e mjaftueshme sepse kufizohemi që në kuadër të Shpenzimeve Operativ t'i fusim edhe shpenzimet për Subvencione në Bujqësi , kjo kategori është e limituar. Komuna e Vushtrrisë ka një politikë të miratuar me dokumentet Strategjike për Subvencionimin e bujqësisë, mirëpo këtë nuk mund ta realizojmë përmes Subvencioneve dhe jemi të detyruar që Bujqësinë ta ndihmojmë përmes të shpenzimeve kapitale gjë që vihemi në kundërshtim me planin kontabël, prandaj kërkojmë nga Ministria e Financave që Limitet për Shpenzime Operative të kenë një fleksibilitet pa i ndryshuar kufijtë Buxhetor

Shpenzimet Kapitale - paraqesin një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve të përgjithshme edhe gjatë periudhës afatmesme do të ketë një pjesëmarrje të rëndësishme . Komuna do të ketë projekt kapitale sipas një liste prioritare

Korniza buxhetore komunale, në euro

| Përshkrimi | 2015 (buxheti aktual) | 2016 (plani) | 2017 (përlllogaritje) | 2018 (përlllogaritje) |
|--|-----------------------|-------------------|-----------------------|-----------------------|
| 1. GJITHSEJ TË HYRAT KOMUNALE | 14.625.419 | 14.587.091 | 14.682.812 | 14.823.295 |
| 1. Të hyra vetanake | 1.675.327 | 1.703.418 | 1.703.418 | 1.730.000 |
| 1. Grantet dhe transferet qeveritare | 12.950.092 | 12.883.673 | 12.979.394 | 13.093.295 |
| 2. GJITHSEJ SHPENZIMET KOMUNALE | 14.625.419 | 14.587.091 | 14.682.812 | 14.823.295 |
| 2. Shpenzime rrjedhëse | 10.936.092 | 11.817.170 | 11.866.448 | 11.978.374 |
| Paga dhe mëditje | 9.110.000 | 9.571.670 | 9.609.948 | 9.680.874 |
| Mallra dhe shërbime | 1.381.830 | 1.381.500 | 1.390.500 | 1.424.500 |
| Komunalitë | 222.242 | 234.000 | 234.000 | 242.000 |
| Subvencione | 222.500 | 630.000 | 632.000 | 631.000 |
| 2. Shpenzime kapitale | 3.688.847 | 2.769.921 | 2.813.364 | 2.844.921 |

Të merret parasysh politikat qendrore që do të kenë ndikim në shpenzimet e ardhshme:
Zbatimi i Ligjit për pagat e shërbyesve civil të Kosovës – rritja e mundshme e pagave

Politikat e zbatuara nga viti 2013 e tutje, sa i përket trajtimit të mirëqenies sociale si autoritet i decentralizuar në Komunitet e Kosovës???

Hyrje në tabelat e hollësishme të shpenzimeve sipas kategorive ekonomike

Shpenzimet komunale të shpërndara sipas kategorive ekonomike dhe programeve – Viti aktual 2015

| Programet | 2015 | | | | | |
|---|------------------|------------------|----------------|----------------|--------------------|-------------------|
| | Paga/Mëditje | Mallra/Shërbime | Komunali | Subvencione | Investime Kapitale | Gjithsej |
| Zyra e Kryetarit | 146.281 | 55.000 | | 10.000 | | 211.281 |
| Zyra e Kuvendit Komunal | 121.577 | 3.000 | | 5.000 | | 129.577 |
| Administrata dhe Personeli | 154.695 | 127.800 | | | 15.000 | 297.495 |
| Inspektimet | 77.733 | 18.700 | | | | 96.433 |
| Prokurimi | 24.786 | 7.360 | | | | 32.146 |
| Buxheti dhe financat | 152.299 | 14.000 | | | | 166.299 |
| Infrastruktura Publike | 60.828 | 213.542 | 102.000 | | 717.047 | 1093.417 |
| Zjarrfikësit dhe Inspektimet | 183.828 | 57.950 | | | | 241.778 |
| Menaxhimi i katastrofave natyrore | 23.682 | 12.500 | | | | 36.182 |
| Zyra Komunale për Komunitete | 42.992 | 4.500 | 2.542 | | | 50.034 |
| Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural | 76.924 | 30.300 | | | 335.000 | 442.224 |
| Kadastra dhe Gjeodezia | 70.696 | 7.646 | | | 250.000 | 328.342 |
| Planifikimi urban dhe mjedisi | 46.456 | 7.420 | | | 1.595.000 | 1.648.876 |
| Shëndetësia | 1.293.332 | 187.200 | 35.000 | 96.000 | 186.800 | 1.798.332 |
| Administrata | 28.196 | 2.200 | | 66.000 | | 96.396 |
| Shërbimet e kujdesit shëndetësor primar | 1.265.136 | 185.000 | 35.000 | 30.000 | 186.800 | 1.701.936 |
| Shërbimet sociale | 64.711 | 25.590 | 3.000 | | | 93.301 |
| Kultura, rinia dhe sporti | 168.994 | 27.436 | | 76.500 | 75.000 | 347.930 |
| Arsimi dhe shkenca | 6.400.186 | 578.886 | 79.700 | 35.000 | 515.000 | 7.608.772 |
| administrata | 64.356 | 332.278 | | 35.000 | 515.000 | 946.634 |
| Arsimi parashkollor | 139.496 | 38.923 | 8.200 | | | 186.619 |
| Shkollimi fillor | 4.679.421 | 160.015 | 54.000 | | | 4.893.436 |
| Shkollimi i mesëm | 1.516.913 | 47.670 | 17.500 | | | 1.582.083 |
| Gjithsej | 9.110.000 | 1.381.830 | 222.242 | 222.500 | 3.688.847 | 14.625.419 |

Tabela xx: Shpenzimet komunale të shpërndara sipas kategorive ekonomike dhe programeve – Viti i ardhshëm financiar 2014

| Programet | 2016 | | | | | |
|---|------------------|------------------|----------------|----------------|--------------------|-------------------|
| | Paga/Mëditje | Mallra/Shërbime | Komunali | Subvencione | Investime Kapitale | Gjithsej |
| Zyra e Kryetarit | 163.200 | 53.000 | | 15.000 | 400.000 | 231.200 |
| Zyra e Kuvendit Komunal | 121.560 | 5.000 | | | | 126.560 |
| Administrata dhe Personeli | 168.819 | 134.000 | | | 50.000 | 352.819 |
| Inspektimet | 85.763 | 16.000 | | | | 101.763 |
| Prokurimi | 28.063 | 7.000 | | | | 35.063 |
| Buxheti dhe financat | 167.763 | 20.000 | | | | 187.763 |
| Infrastruktura Publike | 66.778 | 215.000 | 105.000 | | 420.000 | 1.006.778 |
| Zjarrfikësit dhe Inspektimet | 198.761 | 56.000 | | | | 254.761 |
| Menaxhimi i katastrofave natyrore | 26.594 | 11.500 | | | | 38.094 |
| Zyra Komunale për Komunitete | 45.362 | 5.000 | 3.000 | | | 53.362 |
| Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural | 84.817 | 30.000 | | 400.000 | | 514.817 |
| Kadastra dhe Gjeodezia | 77.137 | 7.000 | | | 100.000 | 184.137 |
| Planifikimi urban dhe mjedisi | 50.799 | 7.000 | | | 1.151.325 | 1.429.124 |
| Shëndetësia | 1.432.280 | 238.500 | 38.500 | 100.000 | 78.596 | 1.857.876 |
| Administrata | 32.710 | 2.500 | | 100.000 | | 105.210 |
| Shërbimet e kujdesit shëndetësor primar | 1.328.340 | 210.000 | 35.000 | | 78.596 | 1.651.936 |
| Shërbimet sociale | 71.230 | 26.000 | 3.500 | | | 100.730 |
| Kultura, rinia dhe sporti | 187.807 | 26.500 | | 80.000 | 30.000 | 324.307 |
| Arsimi dhe shkenca | 6.666.167 | 550.000 | 87.500 | 35.000 | 540.000 | 7.888.667 |
| administrata | 68.108 | 300.000 | | 35.000 | 540.000 | 953.108 |
| Arsimi parashkollor | 140.679 | 40.000 | 8.500 | | | 189.179 |
| Shkollimi fillor | 4.944.240 | 165.000 | 60.000 | | | 5.169.240 |
| Shkollimi i mesëm | 1.513.140 | 45.000 | 19.000 | | | 1.577.140 |
| Gjithsej | 9.571.670 | 1.381.500 | 234.000 | 630.000 | 2.769.921 | 14.587.091 |

Vërejtje: KAB 2016-18 bëhet përfundimtare pas miratimit të buxhetit vjetor 2016 nga Kuvendi Komunal

Shpenzimet komunale parashikimet afatmesme për periudhën 2017-2018, të shpërndara sipas kategorive ekonomike dhe programeve


| Programet | 2017 | | | | | | 2018 | | | | | |
|---|------------------|---------------------|-----------|-----------------|-----------|------------|------------------|---------------------|-----------|-----------------|-----------|------------|
| | Paga/ Mëditje | Mallra/ Shërbime | Komunalit | Subvencion e | Kapitale | Gjithsej | Paga/ Mëditje | Mallra/ Shërbime | Komunalit | Subvencion e | Kapitale | Gjithsej |
| Zyra e Kryetarit | 163.852 | 53.500 | | 17.000 | | 234.352 | 164.507 | 55.000 | | 16.000 | | 235.507 |
| Zyra e Kuvendit Komunal | 122.046 | 5.000 | | | | 127.046 | 122.534 | 5.000 | | | | 127.534 |
| Administrata dhe Personeli | 169.494 | 139.00 | | | 30.000 | 338.494 | 170.171 | 144.000 | | | 10.000 | 324.171 |
| Inspektimet | 86.106 | 16.000 | | | | 102.106 | 86.106 | 16.000 | | | | 102.106 |
| Prokurimi | 28.175 | 7.000 | | | | 35.175 | 28.287 | 7.000 | | | | 35.287 |
| Buxheti dhe financat | 168.434 | 20.000 | | | | 188.434 | 169.107 | 20.000 | | | | 189.107 |
| Infrastruktura Publike | 67.045 | 220.000 | 105.00 | | 650.000 | 1.042.045 | 67.313 | 225.000 | 105.000 | | 660.000 | 1.057.313 |
| Zjarrfikësit dhe Inspektimet | 199.556 | 57.000 | | | | 256.556 | 200.354 | 57.500 | | | | 257.854 |
| Menaxhimi i katastrofave natyrore | 26.700 | 12.000 | | | | 38.700 | 26.806 | 12.000 | | | | 38.806 |
| Zyra Komunale për Komunitete | 45.543 | 5.000 | 3.000 | | | 53.543 | 45.725 | 5.000 | 3.000 | | | 53.725 |
| Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural | 85.156 | 33.000 | | 400.000 | | 518.156 | 85.496 | 33.000 | | 400.000 | | 518.496 |
| Kadastra dhe Gjeodezia | 77.445 | 7.000 | | | 100.000 | 184.445 | 77.754 | 7.000 | | | 100.000 | 184.754 |
| Planifikimi urban dhe mjedisi | 51.002 | 7.000 | | | 1.371.325 | 1.429.327 | 51.206 | 7.000 | | | 1.413.882 | 1.472.088 |
| Shëndetësia | 1.438.007 | 232.500 | 38.500 | 100.000 | 49.283 | 1.858.290 | 1.476.598 | 233.000 | 43.500 | 100.000 | 45.283 | 1.898.381 |
| Administrata | 32.840 | 2.500 | | 70.000 | | 105.340 | 32.840 | 2.500 | | 70.000 | | 105.340 |
| Shërbimet e kujdesit shëndetësor primar | 1.333.653. | 204.000 | 35.000 | 30.000 | 49.283 | 1.651.936 | 1.371.958 | 204.000 | 40.000 | 30.000 | 45.283 | 1.691.241 |
| Shërbimet sociale | 71.514 | 26.000 | 3.500 | | | 101.014 | 71.800 | 26.500 | 3.500 | | | 101.800 |
| Kultura, rinia dhe sporti | 188.558 | 26.500 | | 80.000 | 30.000 | 325.058 | 189.312 | 27.000 | | 80.000 | 30.000 | 326.312 |
| Arsimi dhe shkenca | 6.692.829 | 550.000 | 87.500 | 35.000 | 585.756 | 7.951.085 | 6.719.598 | 571.000 | 90.500 | 35.000 | 585.756 | 8.001.854 |
| administrata | 68.380 | 300.000 | | 35.000 | 585.756 | 989.136 | 68.653 | 310.000 | | 35.000 | 585.756 | 999.409 |
| Arsimi parashkollor | 141.241 | 40.000 | 8.500 | | | 189.741 | 141.805 | 45.000 | 8.500 | | | 195.305 |
| Shkollimi fillor | 4.964.016 | 165.000 | 60.000 | | | 5.189.016 | 4.983.872 | 170.000 | 62.000 | | | 5.215.872 |
| Shkollimi i mesëm | 1.519.192 | 45.000 | 19.000 | | | 1.583.192 | 1.525.268 | 46.000 | 20.000 | | | 1.591.268 |
| Gjithsej | 9.609.948 | 1.390.500 | 234.000 | 632.000 | 2.816.364 | 14.682.812 | 9.680.874 | 1.424.500 | 242.000 | 631.000 | 2.844.921 | 14.823.295 |

Plani i zhvillimit kapital

Gjatë viteve të kaluara në Komunë janë zhvilluar një numër i madh i projekteve kapitale të cilat kanë ndikuar në përmirësimin e jetës së qytetarit. Është investuar në rrugë ujësjellës, kanalizime ambulanca, shkolla, në përgjithësi në Infrastrukturë , gjithashtu është investuar edhe në Bujqësi .Vend të rëndësishëm zënë edhe bashkëfinancimi me Donatorë. Nga viti 2013 e deri në vitin 2015 janë Investuar në projekte kapitale 11.721.972.49 € në këtë shumë nuk janë të përfshira investimet direkte.

Investimet në periudhën analizuese kanë shënuar një rritje konstante rreth 6% në vit

Investimet kapitale në periudhën 2013-2015



Kategoria e shpenzimeve kapitale për vitet 2016-2018 pritet të ketë një rënie krahasuar me periudhën paraprake. Një pjesë e konsiderueshme e këtyre shpenzimeve të planifikuara do të mbuloj financimi i projekteve të filluara në disa rrugë nëpër fshatra dhe ndërtimi i shkollave të filluara në vitin 2015. Për aq sa ekzistojnë mjete më shumë se projektet e filluara Komuna do të implementoj projekte të reja bazuar në prioritet që ka

Shërbimet Publike.- Komuna e Vushtrrisë ka një rrjet të rrugëve prej 367 km, prej të cilave 309 km janë në viset rurale kurse 58 km në zonën urbane, të asfaltuara në total i kemi 346 km. Rrjeti i ujësjellësit është i shpërndarë në tërë qytetin dhe rreth 29 fshatra kryesisht në pjesën lindore të komunës, ndërsa tashmë ka filluar shtrirja e rrjetit edhe në pjesën perëndimore i cili është prioritet i Komunës. Nevojë imediate është ndërtimi i rrjetit primar të kanalizimit nëpër fshatra sepse kryesisht lagjet kanë bërë ndërtimin e rrjetit sekondar përmes furnizimit me gypa të cilin e ka bërë Drejtoria e Shërbimeve Publike, mirëpo derdhja e tyre kryesisht bëhet nëpër lumenj, prandaj Komuna e Vushtrrisë gjatë vitit të kaluar ka planifikuar që përmes kontratave dy vjeçare të bëjë shtrirjen e rrjetit primar kryesisht përgjatë rrjedhave të lumenjve.

Aktualisht kanë përfunduar punët rreth ndërtimit të fabrikës së ujit në Balinc, ndërsa objekti dhe pajisjet-stabilimentet janë në fazën e testimit të tyre. Është kjo një fabrikë me kapacitet rreth 350 l/s dhe pas shtrirjes së rrjetit në të gjitha fshatrat e Komunës ky kapacitet do të plotësoj nevojat e të gjitha ekonomive familjare sa ka Komuna e Vushtrrisë.

Prioritetet e Komunës janë kryesisht në përfundimin e ndërtimit të infrastrukturës rrugore, ku deri më tani janë rregulluar rreth 94 % të rrjetit të tërësishëm, hartimit dhe zbatimit të Planit Lokal pesëvjeçar të Menaxhimit të Mbeturinave, shtrirja e rrjetit të ujësjellësit edhe në pjesën e mbetur në fshatrat rrëzë Çyçavicës, si dhe ndërtimi i rrjetit primar të kanalizimeve kryesisht nëpër fshatra.

| Përshkrimi i projektit | Prioriteti 1 | Prioriteti 2 | Prioriteti 3 | Prioriteti 4 |
|--|--------------|--------------|--------------|--------------|
| Menaxhimi i mbeturinave | x | | | |
| Ndërtimi i trotuareve | X | | | |
| Ndërtimi i rrugëve me kuba betoni | X | | | |
| Furnizimi me gypa | X | | | |
| Riasfaltimi i rrugëve dhe mirëmbajtja | X | | | |
| Ndërtimi i rrjetit të ndriçimit publik | X | | | |
| Ndërtimi i shtatoreve | | x | | |
| Ndërtimi i urave | | x | | |
| Blerjen e mjeteve motorike për nevojat e komunës | | X | | |
| Sinjalizimi horizontal dhe vertikal | x | | | |
| Mirëmbajtja e hapësirave publike | x | | | |

Arsimi dhe Edukimi zë vend të rëndësishëm në dokumentet strategjike të Komunës ,duke bërë përpjekje për një: sistem arsimor dhe cilësor, zhvillim teknologjik që mbështetet në inovacion, zhvillim infrastrukturor arsimor, digjitalizim të shkollave, edukim në bazë të nevojave të tregut.

Arsimi si sinonim i ndryshimit, çdo ditë e më shumë po shërben që dijen ta integrojë në një ardhme të sigurt. Në funksion të tillë shërbejnë 52 shkolla në Komunën e Vushtrisë . Ndërtimi i gjimnazit “ Eqrem Qabej” ka ndikuar pozitivisht në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësim nxënies .Me zgjerimin e hapësirave shkollore janë mundësuar shtimi i aktiviteteve praktike. Arsimi tashmë po shkon drejt një zhvillimi të qëndrueshëm të dijës që të prodhojë kuadro për ekonomi dhe për shtet. Përpjekjet e Komunës do të jenë insistuese drejt ndërtimit dhe renovimit të objekteve shkollore ,në mënyrë që të krijohen kushte më të favorshme për arsim gjithëpërfshirës , cilësor, bashkëkohor dhe në hap me kurrikulat të reja.

Gjatë vitit 2015 është investuar në ndërtimin e tri shkollave fillore Druar, Pantinë dhe Maxhunaj të cilat janë projekte trevjeçare, renovimi i disa shkollave fillore, ndërtimi i fushave sportive , rrethojave. Gjatë periudhës 2016-2018 parashihet vazhdimi i projekteve të filluara si dhe ndërtimi i shkollës fillore “Bajram Curri” në Dumnicë .

| Përshkrimi i projektit | Prioriteti 1 | Prioriteti 2 | Prioriteti 3 | Prioriteti 4 |
|--|--------------|--------------|--------------|--------------|
| Ndërtimi i objekteve shkollore Pantinë, Druar dhe Maxhunaj | X | | | |
| Ndërtimi i shkollës Bajram Curri | | X | | |
| Renovimi i shkollave | | X | | |
| Ndërtimi i rrethojave të shkollave | X | | | |

| | | | | |
|--|--|----------|--|--|
| Ndërtimi i fushave sportive | | X | | |
| Instalimi i nxehjes qendrore | | X | | |
| Ndërtimi i objekteve përcjellës | | X | | |

Shëndetësia dhe Mirëqenies.- Konsiston në shërbime cilësorë shëndetësore dhe sociale, digjitalizim tëi data bazave, vazhdim i investimeve në infrastrukturë eliminimi i sëmundjeve epidemike, zhvillimi i qendrës emergjente, avancimi i Mjekësisë Familjare dhe zhvillim të vazhdueshëm profesional të Personelit Shëndetësor Shërbimi i Kujdesit Primar Shëndetësor i ka dy qendra të mjekësisë familjare në qytet , në të gjitha bashkësitë lokale janë te ndërtuara ambulanca, mirëpo në bazë të Strategjisë dhe nevojave për shërbime më cilësorë kemi nevojë për ambulanca të reja ,këtë vit kemi filluar ndërtimin e një ambulante e cila është projekt dy vjeçar gjithashtu do të investohet në blerjen e automjeteve të Ndhmës së Shpejtë ,automjete tereni etj.

Planifikimi Urban dhe Mjedisi

| Përshkrimi i projektit | Prioriteti 1 | Prioriteti 2 | Prioriteti 3 | Prioriteti 4 |
|---|---------------------|---------------------|---------------------|---------------------|
| Hartimi i planeve rregullues | X | | | |
| Ndërtimi i kanalizimeve neper fshatra | X | | | |
| Ndërtimi i kolektorit te ujerave te zeza | X | | | |
| Asfaltimi i rrugëve neper fshatra dhe lagjeve ne qytet | X | | | |
| Ndërtimi i rrjetit te ujësjellësit | X | | | |
| Fondi për bashkëfinancim me donator | X | | | |
| Hartimi i projekteve | X | | | |

